



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr _____ Pr

Berat, më ___/09/2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontrates - PUNE

**PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PER KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT : "“NDERHYRJE REHABILITUESE NE MURE MBAJTESE
DHE TERRENE NE TERRITORIN E BASHKISE NE KUADER TE MBROJTJES CIVILE**

**KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT - 4500000-7 Punime
ndërtimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT : 8.333.747.83(tete milione e treqindtridhjetë e tremijë e shtatëqind e
dyzete e shtatë) Leke pa T.V.SH .**

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", nenin 2, pika 2/c dhe nenit 78,
pika 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit dhe miratimin e
specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me
poshte :

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021,2022) të paraqitura
në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

është ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: *Këto kritere janë vendosur në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, bazuar në neni 42 të Aktit Normativ 9/2019, nenin 77, pika 3, e LPP dhe nenit 43, pika 5, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Autoriteti në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pese viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
2. Situacionin përfundimtar të objektit;
3. Fatura tatimore përfundimtare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posacme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;

1.3.2 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuara me ligj si më poshtë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NP -1A - Punime germimi ne toke

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NS-1A -Punime per prishjen e ndertimeve.

NS-8 A - Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.

NS-18 A- Punime topogjeodezike. Petro kjo duhet te hiqet pasi nuk eshte e nevojshme per mua eshte e tepert.

- sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1 A	Punime germimi ne toke	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S-1A	Punime prishjen ndertimeve	Prishje soleta b/a		Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N. S -8 A	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	Struktura monolite betoni C 20/25 (muri b/a) F.V. hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

NS - 18A	Punime topogjeodezike.	Lidhet me piketimin e objektit, kuotat per sitemimin e sheshit etj.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

2.3.5-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë - 1 (një) Inxhinier topograf /Gjeodet me kontrate pune ose kontrate bashkepunimi.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.4 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

- **Inxhinieri i ndertimit** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te punimeve te objektit qe prokurohet per secilin nga zerat e punimeve ndertimore referuar preventivit.
- **Inxhinieri Topograf/ Gjeodet** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te kuotave te projektit objekt prokurimi.
- **Argumentimi:***Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.
Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “*drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” .

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar *punonjës të kualifikuar* për realizimin e zërave të veçanta të punimeve, të pajisur me dëshmi kualifikimi, minimalisht si më poshtë:

- Punonjës teknik ndërtimi 1 (një)
- Saldator 3 (tre)
- Karpentier 3(tre)
- Puntor lartesisie 4 (kater)
- Hekur kthyes 2(dy)
- Murator 3(tre)
- Shofer 1(nje)
- Manovrator 1(nje)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ose ekuivalent.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve te punes	Nr.certifikates profesion	Institucioni/Subjekti certifikues
----	--------------	------------	--	---------------------------	-----------------------------------

- **Argumentimi:***Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Konkretisht:

- **Tekniku i ndertimit** eshte i nevojshem per ndjekjen e realizimin te punimeve te ndertimit, sipas zerave te preventivit.
- **Saldatori** eshte i nevojshem per saldimin dhe montimin e pjeseve te parapregatitura beton arme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- **Karpentieri** janë të nevojshëm gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve për punime të ndryshme në kantier.
- **Punetoret e lartesisë** janë të nevojshëm për kalloposjen e murit në lartësi dhe punimet që do të kryhen kërkojnë njëzë të trajnuar për punime në lartësi për vendosjen e rrjetës
- **Hekurkthyesit** janë të domozdoshëm në objekt për punimin edhe lidhjen e hekurit të murit.
- **Murator** janë të nevojshëm për ndertimin e murit të gurit mbajtes.
- **Shofer** për drejtimin e mjeteve të nevojshme për ekzekutimin e punimeve.
- Manovrator për drejtimin e mjeteve të nevojshme për ekzekutimin e punimeve.

2.3.8 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **20(njezete) punonjës** për muajin e fundit. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për muajin Gusht
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin Gusht

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për njëpunësim të paktën 30 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% të kostos.

2.3.9 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë si me poshte :

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalente

ISO 45001-2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose ekuivalente

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues , kapaciteti mbajtës jo me pak se 18 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
2	Kamion me vinc 4 x 4	në pronësi ose me qera	cope	1
3	Eskavator me zinxhire deri 8 ton	në pronësi ose me qera	copë	1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

4	Kamiocine	në pronësi ose me qera	copë	1
5	Betonier Kantieri	në pronësi ose me qera	copë	1
6	Skeleri	në pronësi	M2	200
7	Tabela sinjalistike	në pronësi ose me qera	copë	10
9	Komplet i ndihmes se shpejt	Ne pronesi ose me qera	cope	6
10	Prozhektor ndricimi naten	Ne pronesi ose me qera	cope	6
11	Matrapik per thyerje betoni	Ne pronesi ose me qera	cope	1
12	Saldatrice	Ne pronesi ose me qera	cope	1
13	Vibrator betoni	Ne pronesi ose me qera	cope	1

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 “Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 “Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” si më poshtë vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 6(gjashtë) copë
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 6 (gjashtë) copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) cope
- a) *Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerase, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*
- c) *Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- d) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.*
- e) *Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.*
- f) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- g) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- h) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- i) *Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me makinerite/pajisjet qe disponon sipas formatit te meposhtem:*

Nr	Lloji i mjetit	Specifikime teknike si tonazhi, kapaciteti mbajtes etj.	Pronesi/Qira	Data e nenshkrimit te kontrates se qirase/blerjes	Mandat pagesat bankare

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- **Kamiona vetshkarkues** duhen per transportin e dherave ne objekt dhe materialeve te ndryshme.
- **Kamion me vinc 4 x 4** eshte i nevojshem per transportin dhe shkarkimin e materialeve hekur,cimento ne nje kohe sa me te shkurter.
- **Eskavator me zinxhire** eshte i nevojshem per sistemimin dhe hapjen e vendit ku do te kryhet punimet.
- Kamiocina** eshte e nevojshme per transportin e materialeve brenda kantierit .
- Betoniere kantieri** eshte e domozdoshme per punime betoni ne Objekt sipas zerave te preventivit.
- Skeleri** eshte e nevojshme per punimet ne lartesi.

- **Tabelat sinjalistike** jane te nevojshme per sinjalistiken ne objekt.

- **Komplet i ndihmes se shpejt** eshte mjaft i nevojshem per tu dhene ndihmen e shpejte punonjesve dhe manovratoreve ne objekt ne rast aksidentesh.

- Matrapik per thyerje betoni.** eshte i domozdoshem per tyerjen e elementeve beton arme.

- Vibrator betoni** eshte i domozdoshem per vibrimin dhe ngjeshjen e betonit.

- Saldatrice** eshte e domozdoshme per saldimin,drejtimin ,bashkimin e detajeve te ndryshem me bashkimin e objekteve te madhesive dhe formave te ndryshme duke perdorue mjetet dhe pajisjes e duhura.

- Prozhektori** eshte e domozdoshme per ndricim naten.

Argumentimi:Kërkesat e mesiperme jane vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes



REPubLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr.	Nr. i Analizës	Emërtimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Sasia op/njese	Totali ore pune
A - Zona e emergjencës nr.1 (Lagjia "Barikade" - Depo e Ujit)						
A.1 - Punime prishje						
1	2.426/4	Prishje soleta b/a	m3	57.15	25.70	1,468.76
2	2.37/5a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	57.15	1.80	102.87
A.2 - Punime muri mbajtës						
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet	m3	339.19	0.11	37.31
2	2.37/5a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	339.19	1.80	610.55
3	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm (poshte shtreses C 12/15)	m2	72.00	0.13	9.36
4	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (poshte themelit)	m3	6.60	13.00	85.80
5	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (muri b/a)	m3	46.11	12.80	590.17
6	3.287	F.V. hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	0.05	61.00	3.18
7	3.288	F.V. hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	ton	3.11	42.00	130.52
8	3.653	Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 150 (me vrima, për drenazh pas mureve)	m	30.00	0.50	15.00
9	3.654	Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 100 (në mur, për kullimin e ujrave çdo 10m)	m	24.00	0.31	7.44
10	3.48/b	Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme	m2	132.92	0.45	59.81
11	3.An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	156.43	0.04	6.26
B- Zona e emergjencës nr.2 (Lagjia "Muzakaj" - Gropa e Zhurit)						
B.1 - Punime rrjetë skarpate						
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet	m3	20.46	0.11	2.25
2	2.37/5a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	20.46	1.80	36.83



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

3	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (tra b/a)	m3	20.46	12.80	261.89
4	3.287	F.V. hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	0.74	61.00	45.10
5	An-5	Mbrojtja e skarpatave me rrjete teli, nga renja e gureve	m2	2,024.31	3.10	6,275.37
C - Zona e emergjencës nr.3 (Lagjia "28 Nentori")						
C.1 - Punime muri mbajtës						
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet	m3	157.47	0.11	17.32
2	2.37/5a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	157.47	1.80	283.45
3	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm (poshte shtreses C 12/15)	m2	65.60	0.13	8.53
4	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 t=10cm (poshte themelit)	m3	5.89	13.00	76.57
5	3.322	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M25	m3	57.89	9.30	538.38
6	3.653	Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 150 (me vrima, për drenazh pas mureve)	m	42.00	0.50	21.00
7	3.654	Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 100 (në mur, për kullimin e ujrave çdo 10m)	m	28.00	0.31	8.68
8	3.48/b	Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme	m2	88.82	0.45	39.97
9	3.An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	137.55	0.04	5.50
			ore pune	10,744.68		

-Nga zberthimi i preventivit kemi 10744ore / 10744/8 =1348 dite pune

Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi:Specifikimet teknike dhe fondi limit jane hartuar nga projektuesi dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në Nr.629, DATË 15.07.2015 "PËR MIRATIMIN E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA JURIDIKE

MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRË (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Në specifikimet teknike, ne rastet kur është përmendur një markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, do të pranohen ose ekuivalente”.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***